- t) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor; UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).
- u) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 07.09.2018 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shpesh të shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.
- Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë pranë Drejtorisë së Prokurimit UKT sha.

Operatori Ekonomik “Dajti Park 2007” shpk ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtëme:

1. Kamioncine me targa TR4185T me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **3.1T**
2. Kamion me targa AA042EN me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **15.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
3. Kamion me targa AA208NE me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **17.1 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
4. Kamion me targa AA210NE me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **17.6 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
5. Kamioncine me targa AA115KZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **3.8T**
6. Kamioncine me targa AA946PU me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **0.6Ton**
7. Kamion me targa AA894HH me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **9.8Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
8. Kamion me targa TR1982M me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **5.5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
9. Kamionçinë me targa AA718OA me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.2 Ton**
10. Kamionçinë me targa AA213OE me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.1 Ton**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri dy kamiona me

kapacitetin e duhur nga tre të kërkuar në shtojcën 10/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamionçina **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamionçinë nga katër të kërkuara.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton të kërkuar nga AK (3 copë) si dhe është i paplotë lidhur me kamionçinat me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton të kërkuar nga AK (4 copë) **për rrjedhje të pavlefshme**

Së dyti AK, ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte të tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

7. Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jënë:

- Grupi I- 3 (tre) punonjës
- Grupi II-2 (dy) punonjës
- Grupi III- 2 (dy) punonjës
- Grupi IV- 2 (dy) punonjës
- Grupi V- 1 (nje) punonjës
- (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur si më poshtë cituar:

Për kategorinë e parë ka paraqitur Punonjësit me iniciale L.L, E.B, XH.Q

Për kategorinë e dytë , punonjësit me iniciale R.V, N.S, E.B, I.M, A.LL, I.L, I.S,

Për kategorinë e tretë , operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriterin e kërkuar nga AK.

Për kategorinë e katërt , punonjësit me iniciale D.K, L.Q

Për kategorinë e pestë, punonjësit me iniciale Y.K

Pra sa më sipër Shoqëria **“Dajti Park 2007” shpk** nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: **Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....**

Së treti AK, ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte të tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per tre muajt e fundit

Operatori ekonomik i mësipërm në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur personat me inicialet e mëposhtme:

I.Q (eskavatorist)

G.B (eskavatorist)

D.K (eskavatorist)

I.D(eskavatorist)

Nga sa vihet re më sipër operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator të paisur me dëshmitë drejtimit për automakinist. Për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për të përmbushur kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “SENKA” sh.p.k, me vlerë të ofertës 31.965.978 (tridhjetë e një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

AK, në dokumentat e Tenderit ka kërkuar si më poshtë cituar:

15. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fadrome me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma 0.25 m3</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>kamion</i>		
<i>Autobetoniere</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinc</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë</i>	<i>4 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makine per ngjitje tubash PE</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Tokmak elektrik</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompe uji</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motogjenerator</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Saldatriçe</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- *Kokore minimumi 40 cope*
- *Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 cope*
- *Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 cope*
- *Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 cope*
- *Kulle ndricimi – 1 cope*
- *Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 cope*
- *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 cope*

a. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jënë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b. Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c. Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata perkatese noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

f. Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).

g. (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 07.09.2018 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në

këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.

Operatori Ekonomik "SENKA" shpk ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtëme:

- Kamion me targa AA864CJ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **8.9 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
- Autovinç me targa AA845CZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **7.5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
- Kamionçinë me targa AA658TY me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton)**
- Kamion me targa AA518DJ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **6.5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
- Kamion me targa AA435AV me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
- Kamion me targa AA236NG me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
- Kamionin me targa AA628KR me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
- Kamion me targa AA718RO me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
- Kamionçinë me targa AA563RD me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.6 Ton Më datën 30.08.2018 pranë UKT sha është zhvilluar procedura me objekt prokurimi ;Shtesë e Impiantit të Përpunimit të ujit të pishëmBovillë me 1800 l/sek , ku theksojmë se operator pjesmarrës në garë ka qënë shoqëria 2T shpk si bashkim operatorësh me shoqërinë "Fusha " shpk , oferta e të cilëve është shpallur oferta fituese . Në shtojcën 10 të makinerive shoqëria 2T ka deklaruar si kamionçinë mjetin me targa AA563RD (në pronësi). Theksojmë se ky mjet është i angazhuar në kontratën e mësipërme Për sa kohë që pranë AK , UKT sha ka dalë njoftim fituesi për procedurën në fjalë operatori ekonomik Senka nuk duhet ta paraqesë këtë mjet në shtojcën nr.10.**
- Kamionçinë me targa AA564 RD me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.6 Ton Më datën 30.08.2018 pranë UKT sha është zhvilluar procedura me objekt prokurimi ;Shtesë e Impiantit të Përpunimit të ujit të pishëmBovillë me 1800 l/sek , ku theksojmë se operator pjesmarrës në garë ka qënë shoqëria 2T shpk si bashkim operatorësh me shoqërinë "Fusha " shpk , oferta e të cilëve është shpallur oferta fituese . Në shtojcën 10 të makinerive shoqëria 2T ka deklaruar si kamionçinë mjetin me**

targa AA563RD (në pronësi). Theksojmë se ky mjet është i angazhuar në kontratën e mësipërme Për sa kohë që pranë AK , UKT sha ka dalë njoftim fituesi për procedurën në fjalë operatori ekonomik Senka nuk duhet ta paraqesë këtë mjet në shtojcën nr.10.

- Kamionçinë me targa AA565 RD me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.6 Ton Më datën 30.08.2018 pranë UKT sha është zhvilluar procedura me objekt prokurimi ;Shtesë e Impiantit të Përpunimit të ujit të pishëmBovillë me 1800 l/sek , ku theksojmë se operator pjesmarrës në garë ka qënë shoqëria 2T shpk si bashkim operatorësh me shoqërinë “Fusha “ shpk , oferta e të cilëve është shpallur oferta fituese . Në shtojcën 10 të makinerive shoqëria 2T ka deklaruar si kamionçinë mjetin me targa AA563RD (në pronësi). Theksojmë se ky mjet është i angazhuar në kontratën e mësipërme** Për sa kohë që pranë AK , UKT sha ka dalë njoftim fituesi për procedurën në fjalë operatori ekonomik Senka nuk duhet ta paraqesë këtë mjet në shtojcën nr.10.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamionçina **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nga katër kamionçina ka paraqitur vetëm një kamionçinë me kapacitetin e duhur mbajtës , pasi tre kamionçinat e tjera I ka të angazhuara në kontrata të shpallura fitues pranë AK, UKT sha kjo bie në kundërshtim me pikën 15 gërma f të dokumentave standarte të tenderit si më poshtë cituar: *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha.*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionçinat me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton te kerkuar nga AK (4 copë) **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- 6. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Arb &Trans 2010” sh.p.k. & “KUPA” sh.p.k** me vlerë të ofertës **33.602.136** (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e dy mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë)lekë pa TVSH .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

6.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune

të vlefshme, Urdhër mjeku (i vlefshëm), diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)

*Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorëve ekonomik në sistemin elektronik të app-së rezulton se operatori ekonomik ARB-Trans 2010 nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar se disponon si pjesë të stafit të punësuar mjek të përgjithshëm. Vlen të theksohet se Operatori ekonomik pjesmarrës ka të punësuar më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës konkretisht për periudhën **Korrik 2017 - Korrik 2018** 25(njëzetë e pesë) punonjës , sa më sipër ka detyrim ligjor në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 plotësimin e kërkesës së mësipërme.)*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik lidhur me kriterin e mësipërm të kërkuar nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit , është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

7. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Viante Konstruksion” shpk, me vlerë të ofertës 33.685.909,17 (tridhjetë e tre million e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntë presje shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK, në dokumentat e Tenderit ka kërkuar si më poshtë cituar:

15.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera

Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompe uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatriçe	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 40 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kulle ndricimi – 1 cope
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose

me qera me qellim verifikimi).

- g) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 07.09.2018 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shitesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.

Operatori Ekonomik “Viante” shpk ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtëme:

- a. Kamionçinë me targa AA780 DB me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.02 Ton**
- b. Kamionçinë me targa AA315DF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.01 Ton**
- c. Kamion me targa AA572GJ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **15.5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
- d. Kamion me targa AA154OP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **18.4 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
- e. Kamion me targa AA576NU me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16.2 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
- f. Kamionçinë me targa AA4040RD me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.25 Ton**
- g. Kamioninçinë me targa AA547HX me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.3 Ton**
- h. Autovinç me targa AA325CF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **5.9 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
- i. Fuoristradë me targa AA702AX me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **0.6 Ton**
- j. Kamion me targa SR7741Bme kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **14.1 Ton**
- k. Autovinç me targa AA736Ë me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **6.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)**
- l. Kamioninçinë me targa AA541SI me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **1.1 Ton**
- m. Kamioninçinë me targa AA812RK me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **0.8 Ton**
- n. Kamionin me targa AA106PM me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **25.3 Ton**
- o. Kamionin me targa AA736PZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **16.4 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë**

- me kapacitet mbajtës 15-20 ton)**
- p. Kamionin me targa AA813RK me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **13.8 Ton**
 - q. Kamionin me targa AA814RK me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **23.9 Ton**
 - r. Kamionin me targa AA852PO me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **24.6 Ton**
 - s. Kamionin me targa AA718SD me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **24.1 Ton**
 - t. Rimorkio me targa ABR308 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **22.2 Ton**
 - u. Rimorkio me targa AER766 me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **24.8 Ton**
 - v. Autovinç me targa AA917JX me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet **13.3 Ton**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamionçina **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur dy kamiona me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionçinat me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton te kërkuar nga AK (4 copë) si dhe me me kamionat me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton te kërkuar nga AK (3 copë) **për rrjedhojë i pavlefshëm**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

8. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Junik” shpk me vlerë të ofertës 34.109.807 (tridhjetë e katër milion e njëqind e nëntë mijë e tetëqind e shtatë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga

ku rezultoi si më poshtë:

Së pari AK, ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte te tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

9.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per tre muajt e fundit

Operatori ekonomik i mësipërm në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur personat me inicialet e mëposhtme:

T.R (eskavatorist)

D.K (eskavatorist)

Sh.A (manovrator)pa dëshmi të drejtimit

I.D(vinçier)

Nga sa vihet re më sipër operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator të paisur me dëshmitë drejtimit për automakinist. Për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për të përmbushur kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së dyti AK, ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte te tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;

b. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

ç. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

d Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;

dh. **Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10**

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Nga verifikimi që AK, bëri në dokumentat e ngarkuar nga operatori ekonomik në sistemin elektronik të app-së, rezultoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur në mënyrë elektronike shtojcën nr.10 të disponimit të mjeteve, pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.

Pra sa më sipër Shoqëria “**Junik**” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, **Kapaciteti Teknik** dhe profesional, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: **Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të

Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

9. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “BIBA X” shpk me vlerë të ofertës 39.212.508 (tridhjetë e nëntë million e dyqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e tetë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin e ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur mbi fondin limit I cili për procedurën e mësipërme ka qënë **38.513.055 (tridhjetë e tetë milion e pesëqind e trembëdhjetë mijë e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

10. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “ALEN – CO” shpk

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “ALEN-CO” sh.p.k nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “ALEN-CO” sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

11. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Fat Group” shpk

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Fat Group” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “Fat Group” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme

të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “**NDREGJONI sh.p.k.**”, me NIPT-i K31329048I me administrator, Z.Xhetan Ndregjoni me vlerë të ofertës **33.592.456** (tridhjetë e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.10.2018

Ankesa: Është paraqitur ankesa nga operatori ekonomik “**JUNIK sh.p.k**” me Nr.K.- 3926 Prot dt.05.10.2018 dhe nga operatori ekonomik “**DAJTI PARK 2007 sh.p.k**” me Nr.22974 prot., datë 08.10.2018 me anë të së cilave kundërshtojn vlerësimin e ofertave për këtë objekt prokurimi duke kërkuar rivlerësimin e ofertave.

Ankesave të mësipërme u është kthyer përgjigje me ane të shkresave me **Nr.K.- 3926 /1Prot dt.05.10.2018 dhe Nr.22974/1 prot., datë 10.10.2018.** duke mos pranuar ankesat e paraqitura prej tyre.

Gjatë afatit kohor për ankesa në KPP është paraqitur ankesë nga O.E “**DAJTI PARK 2007**” SHP.K me ane të shkreses me **Nr.23925 Prot dt.19.10.2018**

Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit **Nr. 817 datë 03.12.2018** vendosi: “*Të mos pranoj ankesën e paraqitur nga O.E “DAJTI PARK 2007” sh.p.k [...]*”

2.Autoriteti Kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së Prokurimit”